



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-29876, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit të Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Rexhë (Avdi) Muriqi me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 31/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit privat me qëllim: "Të Sigurimit të Kushteve të Nevojshme për Funksonimin e Bazave ushtarake në Bellopojë" si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcelat kadastrale nr: 806-2 me sipërfaqe prej 200m² ZK Bellopojë, nr: 919-1 me sipërfaqe prej 1261m² ZK Bellopojë, nr: 919-3 me sipërfaqe prej 500 m² ZK Bellopojë, nr: 919-4 me sipërfaqe 500m² ZK Bellopojë, 919-5 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-6 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-7 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-8 me sipërfaqe prej 742m² ZK Bellopojë, nr: 919-9 me sipërfaqe prej 570m² ZK Bellopojë, nr: 919-10 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-11 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-12 me sipërfaqe prej 662m² ZK Bellopojë, nr: 919-13 me sipërfaqe prej 560m² ZK Bellopojë, nr: 919-14 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-15 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-16 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-17 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-18 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, nr: 919-19 me sipërfaqe prej 560m², nr: 919-20 me sipërfaqe prej 550m² ZK Bellopojë dhe 919-21 me sipërfaqe prej 500m² ZK Bellopojë, në pronësi të Rexhë (Avdi) Muriqi do të merren me qëllim të sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionimin e bazave ushtarake në Bellopojë, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me ngastrat kadastrale numër 5755-100 në sipërfaqe prej 2156m² ZK Pejë dhe nr. 426-0 në sipërfaqe prej 4736m² ZK Pejë, pronë Komuna e Pejës.
- III. Këto prona janë dërguar për Vlerësim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në Prishtinë.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ- së
Arkivës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj